

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 414, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË NDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", shkronja "ë", e pikës 3.1, ndryshon dhe bëhet:
"ë) blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si edhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesësh ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie."
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama